



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:142759

Datë: 12.02.2024

Numri i dokumentit: 05385733

**Ac.nr.2479/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci-kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi, dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.(I.) B., nga Peja, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “N. & A.” Sh.P.K., kundër të paditurës K.S. “S.”, me seli në Prishtinë, rruga “...”, p.nr., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson S.D., me bazë juridike kompensimi i dëmit jo material dhe material, sipas auto përgjegjësisë, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1115/17, të datës 08.02.2021, në seancën e kolegjit me datë 12.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** e pathemelta ankesa e të paditurës K.S. “S.”, me seli në Prishtinë, rruga “...”, p.nr., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1115/17, i datës 08.02.2021, në pikën I, III dhe IV të dispozitivit të aktgjykimit, **VËRTETOHET**.

**II.** Pika II e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar mbetet e pashqyrtuar.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar C.nr.1115/17, të datës 08.02.2021, ka vendosur si në vijim: “ I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR, kërkesëpadia e paditësit H.(I.) B., nga Peja, ashtu që DETYROHET e paditura K.S. “S.”, me seli në Prishtinë, që paditësit H.(I.) B. nga Peja, në emër të kompensimit të dëmit për aksidentin e datës 05.08.2017 ti paguaj shumat e specifikuar si më poshtë:

Dëmi jo material, për dhimbjet e përjetuara fizike 1500 euro, për shkak të frikës së përjetuar 1000 euro. Dëmi material, ndihmë dhe kujdes të huaj 150 euro, ushqim të përforcuar 100 euro, për shpenzimet e mjekimit 20 euro.

II. REFUZOHET PJESËRISHT SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësit H.B. nga Peja përtej shumës së gjykuar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për aksidentin e dt. 05.08.2017 për shumat e specifikuara si më poshtë:

Dëmi jo material, për dhimbjet e përjetuara fizike 1500 euro, për shkak të frikës së përjetuar 1000 euro. Dëmi material, ndihmë dhe kujdes të huaj 150 euro, ushqim të përforcuar 100 euro.

III. DETYROHET e paditura K.S. “S.”, me seli në Prishtinë, që shumat e gjykuara, si në pikën I në dispozitiv të këtij aktgjykimi t’ia paguaj me kamat prej 8% në vit duke llogaritur nga data e marrjes së vendimit e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

IV. DETYROHET e paditura K.S. “S.”, me seli në Prishtinë, që paditësit ti paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 690 euro”.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë e paditura përmes të autorizuarit të saj, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, të prishë aktgjykimin e atakuar dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësi.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, 195, dhe 200 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 19.10.2017, në Gjykata Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar padi kundër të paditurës, për kompensimin e dëmit sipas bazës së autopërgjegjësisë, të pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 05.08.2017. Në referatin e padisë ka parashtruar së pjesëmarrës në këtë aksident komunikacioni rrugor ishte vetura e markës “Mercedes”, me targa të regjistrimit ..., e siguruar tek e paditura, si dhe motoçikleta e markës “Piagio”, të cilën e drejtonte paditësi, dhe së ky aksident është shkaktuar nga i siguruari i të paditurës, ndërsa si pasojë e këtij aksidenti paditësi ka pësuar lëndime trupore për çka është dërguar në Repartin e Emergjencës në Spitalin Rajonal të Pejës, për dhënien e ndihmës mjekësore. Me parashtruesën e dorëzuar në gjykatë me datë 27.01.2021, pala paditëse ka bërë precizimin e kërkesëpadisë bazuar në mendimin e dhënë nga ekspertet mjekësor, ashtu që ka kërkuar që të miratohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, dhe të detyrohet e paditura që paditësit t’ia kompensojë në emër të dëmit jomaterial dhe material shumën e përgjithshme prej 5,530.00 euro, me kamatë në lartësi prej 12% duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim e deri në pagesën

definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit e nën kërcënim të përbarimit. E paditura përmes përgjigjes në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë por vetëm lartësinë e saj.

Gjykata duke vepruar sipas padisë dhe kërkesëpadisë së precizuar të paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.1115/17, të datës 08.02.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se me provat e administruara, është vërtetuar së aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me datën 05.08.2017, rreth orës 10:30 minuta, afër Shkollës Ekonomike në Pejë, i cili aksident është shkaktuar nga i siguruari i të paditurës me policë të sigurimit nr.00060117455. Se aksidenti është shkaktuar nga i siguruari i të paditurës nuk është kontestuar nga e paditura. Gjykata me rastin e caktimit të lartësisë për shpërblimin e dëmit jo material dhe material ka vendosur duke marrë për bazë ekspertizat mjekësore të dhëna nga Dr.E.M., ortoped-traumatolog, dhe Dr.Sh.P.-H., psikiatër, të cilët kanë dhënë mendimin e tyre profesional në seancën e shqyrtimit kryesor me datë 10.12.2020, ku janë deklaruar për natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi si pasojë e këtij aksidenti, dhe sipas ekspertit Dr. E.M., ortoped- traumatolog, natyra e lëndimit është e lehtë, duke konstatuar se ka pësuar ndrydhje të trupit, ndrydhje të qafës si dhe ndrydhje të krahut të djathtë, gërvishtje në duar, në dy këmbët dhe në krahun e djathtë ku vërehet nga fotografitë e marra në çastin e aksidentit. I aksidentuari ka pësuar dhimbje të intensitetit posaçërisht të lartë në kohëzgjatje prej 20 minutave, dhimbje të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 10 ditësh, dhimbje të intensitetit të ulët, ka ende dhimbje kohë pas kohë të cilat menaxhohen me barna, i aksidentuari ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë në kohëzgjatje prej 10 ditësh, për shkak të lëndimit të krahut të djathtë dhe dy këmbët iu ka pamundësuar që të kujdeset për vete, ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar të pasur me proteina dhe vitamina në kohëzgjatje prej 7 ditësh, ka pasur nevojë për tretman fizikal në kohëzgjatje prej 10 ditësh, nuk ka shëmtim, nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor. Ekspertja gjyqësore e psikiatrisë pas shqyrtimit të dokumentacionit mjekësor, shikimit klinik të paditësit dhe intervistës me paditësin deklaro se si pasojë e aksidentit ka përjetuar: frikë primare me kohëzgjatje prej disa sekondave, frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar 3-4 orë pas aksidentit, frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar 1 muaj pas aksidentit e që është përcjellë me çrregullim të gjumit dhe ankthe të natës, indisponim për çka edhe është nevojitur ndihma e psikiatrit si dhe ka marr terapi qetësues, frikë sekondare të intensitetit të ulët i aksidentuari përjeton ende në situata të caktuara kur gjendet në komunikacion që përcillet me pasiguri dhe ri përjetim të ngjarjes dhe ankth, të cilat gjykata e shkallës së parë në tërësi i ka pranuar si mendime profesionale duke ju falur besimin në tërësi, pasi që të njëjtat janë në harmoni me provat që gjithashtu janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës. Gjykata e ka refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, për dëmin material dhe jomaterial përtej shumave të gjykuara, sepse bazuar në mendimet e ekspertëve mjekësor dhe nga ekzaminimi direkt në seancë i paditësit, ka vlerësuar se shumata e

kërkuara nga paditësi për dëmin jomaterial përtej shumave të gjykuara nuk janë në proporcion me të mirën e shkelur dhe qëllimin e kompensimit.

Gjykata e shkallës së parë, lidhur me bazën juridike të kërkesëpadsisë dhe lartësinë e kërkesëpadsisë, ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 136,137,159 par.1 dhe 140, dhe 183 të LMD-së, lidhur me nenin 323 të LPK-së. Lidhur me kamatën, gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 170 dhe 382 të LMD-së, si dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën nr.265/2020 të datës 01.12.2020, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit të Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat pretendon pala ankuuese. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe arsyetimi përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadsisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka paraqitur arsye mjaftueshme në lidhje me bazën e kërkesëpadsisë dhe lidhur me lartësinë e dëmit jo material dhe material, si dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme për shumat e aprovuara për llojet e dëmit dhe format e tij të kërkuara nga paditësi.

Gjykata e Apelit vlerëson se janë të paqëndrueshme pretendimet e ankimore të paditurës për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ku baza juridike e kërkesëpadsisë nuk ishte kontestuese mes palëve ndërgjyqëse, ndërsa lartësinë e kërkesëpadsisë e ka vërtetuar në bazë të mendimeve të ekspertëve mjekësor nga lëmi i ortopedisë-traumatologjisë dhe psikiatrisë, të cilët gjatë ekzaminimit direkt në seancë të paditësit, kanë konstatuar qartë natyrën dhe llojin e lëndimeve trupore, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike dhe të frikës, kohëzgjatjen e nevojës për ndihmën e huaj dhe ushqimin e përforcuar, andaj edhe kjo gjykatë vlerëson se konstatimet e ekspertëve janë profesionale dhe me sqarime të mjaftueshme, për tu vërtetuar format e dëmit dhe lartësia e tyre, ku në bazë të këtyre konstatimeve gjykata edhe ia ka gjykuar shumat për format e dëmit material dhe jomaterial.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar se shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë për dëmin jomaterial janë në proporcion me të mirën e shkelur dhe qëllimin e kompensimit që është një lloj satisfaksioni për palën e dëmtuar që sado pak t'ia zbusë dhimbjet e përjetuara për dëmin e pësuar, e duke pasur parasysh edhe moshën e tij në momentin e aksidentit, por duke u kujdesur njëkohësisht që të mos dëmtohet edhe pala tjetër. Sipas nenit 136 par.1 të LMD-së është paraparë së “*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Tutje neni 137 të LMD-së, përcakton se: “*Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)*”. Ndërsa në nenin 159 par. 1 i LMD-së, është paraparë së: “*Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë*”. Në nenin 179 par.1 të LMD-së, është paraparë së “*Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit*”. Kurse me dispozitën e nenit 183 par.1 dhe 2 të LMD-së përcaktohet se: “*Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të përshtatshme me natyrën e saj dhe me qëllim shoqëror*”. Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase konsideroi se shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë janë proporcionale me lëndimet të cilat i ka pësuar paditësi në aksident dhe të gjitha rrethanave tjera të cilat janë më rëndësi për vlerësimin dhe caktimin e kompensimit, e me të cilat do të arrihej qëllimi i kompensimit të drejtë i dëmit të pësuar në aksidentin në komunikacion, e duke u bazuar në ekspertizat mjekësore, ndërsa shumat e gjykuara për dëmin material e ka bazuar në ekspertizat mjekësore të ekspertëve, të cilët kanë konstatuar se paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e huaj dhe ushqim të përforcuar, e që këto forma të dëmit njihen edhe nga kompanitë e sigurimeve dhe janë të pranuar nga praktika gjyqësore, e të cilat forma të dëmit pranohen edhe pa u arsyetuar me fatura, sepse zakonisht për personat e lënduar kujdeset anëtar i familjes, ndërsa ushqimi i përforcuar zakonisht nuk mund të ndahet nga ushqimi i zakonshëm, prandaj këto forma të dëmit pranohen nga gjykatat, duke u bazuar në ekspertizat mjekësore të cilat konstatojnë nevojën dhe kohëzgjatjen për këto forma të dëmit.

Gjykata e Apelit, ka vlerësuar se kamata e gjykuar është në përputhje me nenin 170 dhe 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestimore, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e nenit 449 452 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar aktgjykimin e atakuar në pikën II të dispozitivit, pasi që nuk kishte pretendime ankimore në këtë drejtim.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
Ac.nr.2479/2021, datë 12.02.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari  
Hysni Bardheci